



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODER
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. ____ Prot.

Shkoder, më ____/____/ 202__

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2022

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik ne Bashkine Shkoder gjatë vitit 2022 eshte bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) *transparencë gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik*
- b) *pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuuese;*
- c) *efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike;*
- d) *përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.*

Procesi është realizuar në zbatim të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Rregullores së Këshilli Bashkiak “Për konsultimin publik” Bashkia Shkoder, Këshilli i Bashkisë.

Bashkia (Ekzekutivi) dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar për të realizimin e një procesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 12 dëgjesa me banorë në qytetin e Shkodres dhe te rrethinave te saj. Ndërkohe, për degjësën për Buxhetin 2023 dhe PBA u realizuan në proces gjithsej 10 takime te dokumentuara me procesverbal te plote, reflektuar¹ edhe ne platformen konsultimivendor.al, ne te cilen Bashkia Shkoder ishte nje nder bashkite pilot te perzgjedhura nga UNDP/STAR3.

Gjate vitit 2022, Bashkia Shkodër bashkëpunoi me Projektin STAR 3, permes Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, per te rritur vizibilitetin e procesit te konsultimit publik si dhe per konsolidimin e një modeli qe mund t’u sherbeje edhe bashkive te tjera te vendit. Te gjitha seancat konsultuese/dëgjesat jane pasqyruar në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Patos, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak si dhe për here të pare në Platformen: www.konsultimivendor.al në faqen e dedikuar Bashkise Shkoder brenda kesaj platforme (<https://konsultimivendor.al/shkoder/>). Bashkia Shkodër u përzgjedh bashkë me 6 bashki të tjera për të pilotuar dhe konsoliduar një praktikë konsultimi që do të shërbejë si model edhe për bashkitë e tjera të Shqipërisë.

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Shkodër në zbatim te detyrimeve qe cakton per autoritetin publik neni 20 i ligjit 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas parashikimeve te ketij neni, organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për

¹ <https://konsultimivendor.al/konsultimet-deri-tani-per-pba-2023-2025/>

transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;*
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;*
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;*
- ç) numrin e takimeve publike të organizuara.*

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2022.**

Këshilli Bashkiak Shkodër miratoi gjithsej 75 vendime gjate vitit 2022² te cilat gjendet të publikuara në faqen zyrtare te Bashkise Shkoder si dhe platformen e centralizuar VENDIME.AL, ne te cilen ato gjithashtu publikohen konform standarit te unifikuar te publikimit.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 38 rekomandime konkrete

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:**

Nga 38 rekomandime, u mbajtën parasysh 28 dhe 9 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publikë që u angazhuan në organizimin/drejtimin e dëgjësave

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Date 31.03.2022 Bashkia Shkoder / Ekzekutivi: Konsultim me publikun mbi Planin Sektorial “Projekti i Sistemit Rrugor për Njësinë Strukturore SH011.UB”.

Bashkia e Shkodrës ftoi ne date 31/03/2022 (data e njoftimit zyrtare ne faqen e internetit) për konsultim qytetarët, teknikienët, këshilltarët dhe palët e interesuara në diskutimin mbi Planin Sektorial “Projekti i Sistemit Rrugor për Njësinë Strukturore SH011.UB”, në këtë kuadër te nismes se Bashkise Shkodër “Për Hartimin e Planit Sektorial ‘Projekti i Sistemit Rrugor për Njësinë Strukturore SH011.UB’ në Bashkinë Shkodër” të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.59, datë 06.12.2021.

Referuar Ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, dhe Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër planizoi konsultim publik me grupet e interest. Dëgjesa publike u thirr ne daten 8 Prill 2022, ora 11:00 në Sallën e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, nr, 1. Kati I.

² Vendimet e vitit 2022 mund te shihen ne likun: <https://www.vendime.al/category/shkoder/2022-shkoder/> si dhe mund te hapen njëkohësisht deirekt nga faqja zyrtare e bashkisë Shkoder ne këtë link: https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php

2. Date 10.06.2022 - Bashkia Shkoder / Keshilli Bashkiak: Këshillim me publikun – Projekt-vendim “Per nje ndryshim ne vkb nr.22 date 18.04.2019 per miratimin e “Planit lokal per veprimin e zhurmes ne mjedis, Bashkia Shkoder”. Njoftimi eshte postuar ne date 16.05.2022 ne faqen zyrtare te bashkise Shkoder. Pranë këshillit bashkiak Shkodër u paraqit për miratim projekt-vendimi “Për një ndryshim në VKB nr.22, datë 18.4.2019 për miratimin e “Planit lokal për veprimin e zhurmes në mjedis të Bashkisë Shkodër. Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Këshilli Bashkiak Shkodër, njoftoi thirrjen e konsultimit me publikun në lidhje me këtë dokument. Sugjerimet, komentet, u percaktua te dergoheshin deri me datë 10.06 .2022, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet email në adresën: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al Bashkëlidhur projektvendimitu publikua online i gjithë dokumentacionin shoqerues i hapur për konsultim.

3. Date 21.07.2022 Bashkia Shkodër / thirrur nga Ekzekutivi: Dëgjese publike per projektin “Ndërtimi i Rrugës Shirokë-Zogaj-Kufi”. Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shkodër, në kuadër të Projektit “Albanian Infrastructure and Tourism Project” (AITP), me financim nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Qeveria Shqiptare, organizuan Dëgjese Publike për Projektin: “Ndërtimi i Rrugës Shirokë- Zogaj- Kufi”.

Takimi konsultativ u përqendrua në prezantimin nga konsulenca / projektuesi të Raportit Teknik, Raportit të Vlerësimit të Pasurisë dhe Censurit të personave që preken nga zbatimi i këtij Projekti. Njoftimi u afishua ne afqen zyrtare te internetit te bashkise Shkoder ne date 22.06.2022.

Për t’u njohur te gjitha palet e interesuara me këtë Projekt, Bashkia shkoder publikoi edhe Planimetrine (https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/planimetria_e_ruges_5042.pdf) e nderhyrjes ne projekt. Në takim u ftuan te marrin pjese autoritete lokale, grupe interesi dhe banorë të zonës. Takimi u planzua te mbahej ditën e Enjte, më datë 21 Korrik 2022, ora 11:00, në Sallën e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, nr, 1. Kati I.

4. Date 7.7.2022 - Bashkia Shkoder / Keshilli Bashkiak thirren Këshillim me publikun mbi VKB: “Për një shtesë në VKB nr.1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër“. Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja “f“, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Këshilli Bashkiak Shkodër, njoftoi ne date 28/06/2022 zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutim të dokumentit. Takimi u planizua te zhvillohej Në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, Shkodër, ditën e enjte, datë 14 Korrik, 2022 ora 12:00. Gjithashtu, sugjerimet, komentet, mund të dërgoheshin deri me datë 28.7.2022, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet email në adresën: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

5. Date 22/08/2022- Bashkia Shkoder / Ekzekutivi: Këshillim me publikun – “Projekti i Sistemit Rrugor dhe Hapësirave Publike për Njësinë Strukturore SH002.UB”. Bashkia e Shkodrës ftoi për konsultim qytetarët, teknikienët, këshilltarët dhe palët e interesuara në diskutimin mbi Projektin e Sistemit Rrugor dhe Hapësirave Publike për Njësinë Strukturore SH002.UB. Referuar Ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, dhe Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër u ndermor konsultim publik me grupet e interesit. Dëgjesa publike u planizua dhe u njoftua permes faqes zyrtare ne internet te zhvillohej në datën 22 Gusht 2022, ora 11:00 në Sallën e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, nr. 1. Kati I.

6. Date: 9.08.2022- Bashkia Shkoder / Ekzekutivi: Konsultim i dokumenteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis – “Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”

Bashkia e Shkodrës ftoi për informim dhe konsultim publik këshilltarët, qytetarët, teknikienët dhe palët e interesuara në lidhje me VNM e “Projektit të zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”, pjesë e korridorit të X-të, mbështetur nga Fondet e Bashkimit Evropian.

Me qëllim informimin dhe përfshirjen e aktorëve vendorë, në mënyrë që të arrihen zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e prekura, Bashkia beri publike paraprakisht te gjithë dokumentacionin e Projektit ne faqen e vet zyrtare në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Bashkia hapi diskutim dhe sugjerime me shkrim nga palët e interesuara mbi dokumentet si më poshtë vijojnë:

1.0 WB16-ALB-TRA-01 Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri ,RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS Korrik 2021 -Rishikuar Korrik 2022

1.1.WB16-ALB-TRA-01 Projekti i Detajuar për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social ,SHTOJCAT Korrik 2021

2. WB16-ALB-TRA-01 Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social ,PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE (Draft raport) -Rishikuar Korrik 2022

3.WB16-ALB-TRA-01 Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri , PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT-rishikuar Korrik 2022

4. WB16-ALB-TRA-01 Projektimi i Detajuar për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri, Studim i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social PLANI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESUARA -Korrik 2021,Rishikuar në Korrik 2022

5.WB16-ALB-TRA-01 Projektimi i Detajuar për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëria ,Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social, KUADRI I MARRJES SË TOKËS DHE RISISTEMIMIT Korrik 2021-Korrik 2022

6. WB16-ALB-TRA-01 Plan i Detajuar për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani I Hotit Shqipëri ,Studimi i Ndikimit Social – Mjedisor PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL, Rishikuar Korrik 2022

7. Date :15.09.2022 BASHKIA SHKODER – Këshillim me publikun për projektplanin buxhetor afatmesëm 2023-2025 (Asistuar nga INFOCIP / STAR 3)

20 Tetor, 2022 – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike ne kuader te “Projekt-Buxhetit Afatmesem 2023-2025” me banoret e lagjes nr.5, duke mbyllur ne kete menyre te gjitha degjesat publike sipas kalendarit te miratuar. Ne kete degjese ishin i pranishem Nenkryetari i Bashkise Shkoder Z.Ardit Cylybyli i bashkeshoqeruar nga anetare te tjere te administrates se Bashkise. Pikat kyce ne cilat u ngrit diskutimi ishin ceshtjet qe lidheshin me problemet qe hasen ne arsimin baze dhe ate parashkollor, menaxhimi i mbetjeve, sherbimet ne komunitet duke u ndalur specifikisht tek ndricimi dhe infrastruktura, rrjeti rrugor dhe sherbimet shendetsore.

19 Tetor, 2022 – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike , me banoret e lagjes Nr.4 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Degjesa u zhvillua ne sallen e Keshillit Bashkiak. Ne kete degjese ishte i pranishem Kryetari i Bashkise z. Bardh SPAHIA. Degjesa me banoret e lagjes nr.4 ishte nje nga degjesat e fundit per Buxhetin 2023 dhe PBA 2023-2025. Fokusi i punës për vitin 2023 dhe vitet në vazhdim, bazuar edhe në kërkesat e komunitetit do të jetë: Rritje e investimeve në infrastrukturën rrugore, shkolla, qendra shëndetësore, kënde sportive dhe parqe publike, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, kryesisht atij të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit rrugor etj, zbatimi i projekteve të reja që i shërbejnë zhvillimit turistik të Shkodrës, duke u përkthyer në një burim të ardhurash ekonomike.

18 Tetor, 2022 / Shkoder – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike te rradhes, me banoret e lagjes Nr.3 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Degjesa u zhvillua ne sallen e Keshillit Bashkiak. Ne menyre homologe, ashtu si dhe ne degjesat e tjera fokusi i diskutimit ishin ceshtje me rendesi te vecante duke filluar nga problemet qe hasen ne arsimin baze dhe ate parashkollor, menaxhimi i mbetjeve, sherbimet ne komunitet duke u ndalur specifikisht tek ndricimi dhe infrastruktura, rrjeti rrugor dhe sherbimet shendetsore. Ky takim u mbeshtet dhe u lehtesua nga Qendra per Çeshtje te Informimit Publik, INFOCIP, ne kuader te Projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbeshtetur nga STAR 3/UNDP

17 Tetor 2022 – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike me banoret e lagjes Nr.2 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Degjesa u zhvillua ne sallen e Keshillit Bashkiak. Degjesa u zhvillua ne Sallen e Keshillit Bashkiak. Ceshtjet per diskutim ne kete degjese publike ishin me rendesi te vecante duke filluar nga problemet qe hasen ne arsimin baze dhe ate parashkollor, menaxhimi i mbetjeve, sherbimet ne komunitet duke u ndalur specifikisht tek ndricimi dhe infrastruktura, rrjeti rrugor dhe sherbimet shendetsore. Fale pjesemarrjes te larte nga ana e banoreve u evidentuan ne menyre konkrete kerkesat dhe problematikat e tyre, ku nje pjese e tyre do te jene prioritet i punes se Bashkise Shkoder. [Shiko dokumentimin e plote me audio/video](#)

14 Tetor, 2022 / Shkoder – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike me banoret e lagjes Nr.1 mbi “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Degjesa u zhvillua në sallen e Keshillit Bashkiak. Ne kete degjese u diskutuan ceshtje me rendesi te vecante, duke filluar nga problemet qe hasen ne arsimin baze dhe ate parashkollor, menaxhimi i mbetjeve, sherbimet ne komunitet si p.sh ndricimi dhe infrastruktura, rrjeti rrugor, sherbimet me ujesjellsin dhe ato shendetsore. Ky takim u mbeshtet dhe u lehtesua nga Qendra per Çeshtje te Informimit Publik, INFOCIP, ne kuader te Projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbeshtetur nga STAR 3/UNDP. [Hap dokumentimin e plote te audio](#)

13 Tetor, 2022 / Shkoder, N.J.A Guri i Zi dhe Berdice – Guri i Zi dhe Berdica ishin dy njësiti administrative të radhës ku u zhvilluan dëgjesat publike për “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”.

12 Tetor, 2022 / Shkoder, N.J. A Postribe – Me Postribën janë përmbyllur konsultimet publike në njësiti administrative të Bashkisë Shkodër “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Turizmi dhe Bujqësia janë dy sektorët kryesor ku do të përqëndrohen investimet dhe zbatimi i projekteve të reja. Infrastruktura rrugore, arsimi, shëndetësia do të jenë në fokus të punës per Bashkine Shkoder, paralelisht me rritjen e standartit të shërbimeve. Të ardhurat që mblidhen në çdo njësi administrative, do të përkthehen në investime që zhvillojnë territorin dhe përmirësojnë jetesën e banorëve, duke frenuar fenomenin e emigrimit, kryesisht të rinisë.

10 Tetor, 2022 / Shkoder, DAJC – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike ne N.J.A. Dajç “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Ne degjese e rradhes me banorët e njësisë administrative Dajç u diskutua mbi problematikat dhe prioritetet e investimeve për zonën e tyre. Takimi u zhvillua ne dy etapa.

07 Tetor 2022/ Shkoder, N.J.A Velipoje – Bashkia Shkoder zhvilloi degjese publike ne N.J.A. Velipoje “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Degjesa u pergatit nga Koordinatorin per Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Rreth 30 banore te zones moren pjese ne kete takim.

05 Tetor 2022/ Shkoder – Bashkia Shkodër nisi dëgjesat publike “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025”. Takimet e parë u zhvillua me banorët e njësisë administrative Rrethina si dhe 3 njësiti Shalë, Shosh, Pult të Dukagjinit. Ne keto takime mori pjese kryetari i Bashkise Shkoder, Bardh Spahia. Takimet u organizuan nga Koordinatorin per Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Z. Fisnik Lutfija

(per te pare te gjitha aktivitete ne foto/video/audio, klikoni per me shume ne:
<https://konsultimivendor.al/konsultimet-deri-tani-per-pba-2023-2025/>)

8. Date: 12.12.2022 Bashkia Shkoder / Ekzekutivi – Keshillim me Publikun ne lidhje me VNM e “Projektit te zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”. Bashkia e Shkodrës ftoi për informim dhe konsultim këshilltarët, qytetarët, teknicienët dhe palët e interesuara në lidhje me VNM e “Projektit të zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”, pjesë e korridorit të X-të, mbështetur nga Fondet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër Hekurudha Shqiptare Sh.a., me zbatuesin ABKONS në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, me qëllim informimin dhe përfshirjen e aktorëve vendorë, në mënyrë që të arrihen zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e prekura, njofton për organizimin e dëgjësës me publikun në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin “Rehabilitimi i Hekurudhës Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri me datë 12 Dhjetor 2022, ora 09:00 pranë sallës së Këshillit Bashkiak Shkodër.

(per te pare te gjitha aktivitete ne foto/video/audio, klikoni per me shume ne:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-shkoder-keshillim-me-publikun-ne-lidhje-me-vnm-e-projektit-te-zbatimit-per-rehabilitimin-e-linjes-hekurudhore-vore-hani-i-hotit-shqiperi/>

9. Date: 21/12/2022 Bashkia Shkoder / Keshilli Bashkiak – Keshillim me Publikun per diskutimin e dokumentit “Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025”

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja “k”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Këshilli Bashkiak Shkodër, njofton zhvillimin e séancës së këshillimit me publikun, për diskutim të dokumentit: “Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025” . Takimi u mbajt në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, Shkodër, ditën e merkure, datë 21 Dhjetor, 2022 ora 12:00.

10. Date 23/12/2022: Bashkia Shkoder / Keshilli Bashkiak – Keshillim me publikun per diskutim te Projekt- vendimit “Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit“.

KALENDARI I AFISHUAR³:

Data e Njoftimit: 22 Nentor 2022

Data e Zhvillimit te Konsultimit: 23 Dhjetor 2022

Ora 12:00

Vendi: Salla e Keshillit Bashkiak Shkoder

³ <https://konsultimivendor.al/bashkia-shkoder-njoftimi-zyrtar-dhe-kalendari-per-diskusim-te-dokumentit-projekt-vendim-per-miratimin-e-kriterëve-te-përdorimit-te-intensitetit-te-ndërtimit-me-kushte-si-instrument-i-zhvillimit/>

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja “k“, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Këshilli Bashkiak Shkodër, njoftoi zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutim të dokumentit: “Projekt-vendim “Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit“. Takimi u planzua te zhvillohej ne sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Shkodër, ditën e premte, datë 23 Dhjetor, 2022 ora 12:00. Sugjerimet, komentet, mund të dërgoheshin deri me datë 23.12.2022, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet e-mail në adresën: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

11. Date: 27/12/2022 - Bashkia Shkoder / Ekzekutivi – Konsultim me Publikun “Për çështjet që trajtohen në Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar”.

Njoftuar nga: Bashkia Shkoder / Ekzekutivi ne date 25/11/2022 per t’u mbajtur ne date 27/12/2022. Lloji/Forma: Konsultim publik me Qytetarët, Teknicienët, Këshilltarët dhe palët e interesuara. Dëgjesa publike u mbaj në datën 27 Dhjetor 2022, ora 11.00 në Sallën e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, nr.1. Kati I.

Bashkia Shkodër ndërmari Nismën Rishikimin e PPV me Proçedurë të Thjeshtuar të miratuar me Vendimin Nr.750, datë 26.10.2022. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër ftoi qytetarët, teknicienët, këshilltarët dhe palët e interesuara në diskutimin mbi çështjet e që do të trajtohen në Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar, të cilat:

- a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave te mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore;*
- b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;*
- c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mospërputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;*
- d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve te shkaktuara nga kriza sektoriale;*
- e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.*

Konceptoi:
Koord.Konsult.Publik
